



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
SH. A UJËSJELLËS – KANALIZIME CËRRIK

Nr. ____ prot.

Cërrik, më 19.08.2022

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[19.08.2022]

Drejtuar: [BOE "Grein-T" sh.p.k "Lagja Sul Papri, Rruga 25 Nentori pallati 129/1 Elbasan, – „VIANTE KONSTRUKSION“ shpk Elbasan Gramsh GRAMSH SPORTI, -dhe „ISOBAR CONSTRUCTION“, Tirane Kashar KASHAR Mezez, toke me numer pasurie 12/14, volumi 2, faqe 97, e ndodhur ne zonen kadastrale 2629]

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedure e hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Ref- 37231-07-27-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Vendosje matësash ne pallatet me kollone te brendshme, Bashkia Cerrik"**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [01.08.2022] [106]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **BOE "Grein-T" sh.p.k – „VIANTE KONSTRUKSION“ shpk-dhe „ISOBAR CONSTRUCTION**
Nr.Nipt L93309201I & K47103804L & L12210036D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **32.867.308** (tridhjetë e dy milion e teteqind e gjashtedhjetë e shtate mije e treqind e tete) (e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. ” “IMAG” Shpk

J82816208R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **pa vlere**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “IMAG” Shpk Nr.Nipt **J82816208R** me oferte me vlere **pa vlere**

Nuk ploteson kërkesat për kualifikim pasi nuk ka paraqitur dokumente kualifikuese në sistemin SPE.

OE nuk ka paraqitur:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formulari i Ofertës sipas shtojcës 1 dhe 2.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të kete në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020, 2021**, ku vlere e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël **se vlere e fondit limit që prokurohet.**

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2019, 2020, 2021**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

- 1.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2021**, pranë njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;
6. Faturat tatimore te prera per objektin;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Fatura tatimore perfundimtare.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - N.P-2 (Ndërtime civile dhe industriale) Nivel A
 - N.P-7 (Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa,) Nivel B
 - N.P-12 (Punime të inxhinjerise se mjedisit) Nivel A
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - N.S.-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve) Nivel A
 - N.S.-2 (Impiante hidrosanitare,) Nivel B
 - N.S.-10 (Shtresa,) Nivel A
 - N.S.-18 (Punime topogjeodezike,) Nivel A
 - N.S.-19 (Sistemet kundër zhurmes,) Nivel Asipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Operatorët ekonomikë duhet të kenë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin liçencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e liçensave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) liçencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e liçensave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

2.3.3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në liçensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimum 10 (dhjetë) vjet.

- i. Libreze pune (përkatëse)
- ii. CV përkatëse
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarime të rreme do të veprhet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma a, të Ligjit 9643, dt 20.11.2006 i ndryshuar “Për Prokurimet Publike”

2.3.4 Staf i kryesor dhe mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinjerët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndertimi 1(një)
- Inxhinier Mjedisi 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)
- Inxhinier Hidroteknik 1(një)
- Inxhinier Topograf/Markshejder 1(një)
- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*), librezë pune, CV.

2.3.5. Stafi Ndhimes/Mbeshtetes/Certifikimet ose Kualifikimet mbeshtetese:

- 1(nje) nga inxhinieret pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si Auditues energjetik (i certifikuar nga Agjensia për Eficiencën e Energjisë në ndertesa). (Për ekspertin Auditues Energjetik te paraqiten Certifikata perkatese leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise si dhe Kontrata e punes (e vlefshme) dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë).
 - 1(nje) prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise duhet te jete i certifikuar si Ekspert Zjarrfikës. (Për ekspertin zjarrfikës certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme) si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë).
 - 1(nje) prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise duhet te jete i certifikuar si Ekspert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. (Për ekspertin e Mjedisit certifikata e ekspertit Mjedisor si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë).
 - 1(nje) prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për "*Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015*", e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj. (Për pergjegjesin e kontrollit te cilesise duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë).
 - 1(nje) prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si "*Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin/menaxhimin e dëmeve në mjedis*", e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj. (Për ekspertin e Demit ne Mjedis duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë)
 - 1(nje) nga inxhinieret pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për "*Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune*", "*Pergjegjes per sigurine*", e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,
 - 1(nje) nga inxhinieret pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për "*Vleresimi dhe dokumentacioni i vleresimit te risqeve ne kantier*", "*Pergjegjes per sigurine*", e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,
 - Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, 1(nje) person te certifikuar per "*Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave*", i cili duhet te figuroje ne listepagese minimalisht per 6 muajt e fundit. (Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet te paraqesi kete certifikate).
 - Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij 4 (kater) specialist te certifikuar per
-

"Punime ne lartesi", te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.

Shenim: Per pikat 2.3.4 dhe kriteri 2.3.5 me nenpikat, si me siper, operatoret ekonomik ofertues mjafton qe ne kete faze te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, mjafton te paraqitet nje mjek per gjithë BOE. Mjeku duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit.

Shenim: Per pikat 1) dhe 2) me nenpikat, si me siper, operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **70 (shtatedhjete)** personave, për periudhën **3 muajt e fundit.**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për për 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e punonjësve të specializuar te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

- 2 Teknik Ndertimi (vertetuar dhe me diplome)
 - 1 Hidraulik
 - 2 Specialist per montim tubash
 - 1 Elektracist
 - 1 Mekanik
 - 1 Murator
-

- Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.
 - Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të pakten 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **3 punonjës manovratorë** të mjeteve të rënda (2 automakinist dhe 1 eskavatorist) dhe **1 shofer kamioni**. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse.

***Shënim:** Për pikën si më sipër, në fazën e ofertimit do të pranohet “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik duhet të paraqesi dokumentacionin provues, sipas deklaratës së mësipërme, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit për paraqitjen e tyre.*

2.3.6 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë:

- a. Nyje Inerte;
- b. Materialet hidraulike - tubo, rakorderi

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11(njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 18(tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 (njetete) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Mini Ngarkues/BOBCAT	1 copë	Pronësi ose me qera
Telehender/Pirun	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkiator	1 copë	Pronësi ose me qera
Prerese Betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Vinc Karrel	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera

Pompe uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor min. 30KW	1 copë	Pronësi ose me qera
Helikopter per lucidim, nivelues	2 copë	Pronësi ose me qera
Pompa suvatimi	3 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	4 copë	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash	1 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier, zyra te levizshme	1 copë	Pronësi ose me qera
Prozhektore kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	2 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 70copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 15copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5copë
- Uniforma/Jelek pune 70cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20copë

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- a) *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) *Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).*
- c) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Deklaratës se shoqërisë ofertuese.*
- f) *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.*

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015** (per sistemin e menaxhimit te cilesise), e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015** (per sistemin e menaxhimit te mjedisit), e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **OHSAS 18001:2007** (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune), ose cetifikaten **ISO 45001-2018** ekuivalente, e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **SA 8000:2014** (per sistemin e menaxhimit te pergjegjesise shoqerore), e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 50001:2011** (per sistemin e menaxhimit te energjise), e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 20121:2012** (per sistemin e menaxhimit te qendrushmerise se eventeve), e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 1452-1:2009** (per sistemin e tubacioneve plastike per f. me uje, kullimet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbitokesore), e vlefshme,

Ne rastin e bashkimit te perkohshem te shoqerive secili operator duhet te paraqese certifikatat e mesiperme, ne varesi te punimeve qe do te marri persiper konform marreveshjes.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.9 a) Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Licence I.2.A "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale te mbrojtjes civile" per sistemet e ekspertizes teknike kundra zjarrit.

b) Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me **Licence III.2.A(1+2)** "**Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis**" - Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis.

c) Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me **Licence III.2.B()** "**Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis**" - Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis-Grumbullim dhe transport i mbetjeve te Ngurta.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

2.3.10 Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.11 Cdo ofertues duhet te paraqese Planorganizimin dhe Planin e Sigurise ne Kantier per punimet ne objekt sipas VKM nr 692 date 13.12.2001 ”Per masat e vecanta te sigurimit dhe te ruajtjes se shendetit ne pune” i ndryshuar.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Oferta e paraqitur nuk merret në shqyrtim pasi që nuk ka paraqitur dokumentacion në të cilin mund të provojë që e realizon objektin e prokurimit dhe për këtë arsye skualifikohet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**BOE "Grein-T" sh.p.k "Lagja Sul Papri, Rruga 25 Nentori pallati 129/1 Elbasan, – „VIANTE KONSTRUKSION“ shpk Elbasan Gramsh GRAMSH SPORTI, -dhe „ISOBAR CONSTRUCTION“, Tirane Kasha KASHAR Mezez, toke me numer pasurie 12/14, volumni 2, faqe 97, e ndodhur në zonën kadastrale 2629**], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **32.867.308** (*tridhjetë e dy milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tetë*)/ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**Administratori
Eneo Tacja**
